

 <p>Liberté • Égalité • Fraternité RÉPUBLIQUE FRANÇAISE</p> <p>MINISTÈRE DE LA JUSTICE</p>	<p style="text-align: center;">7</p> <h2 style="text-align: center;">DEKLARATA E TË DREJTAVE</h2> <p style="text-align: center;">I dorëzohet një të mituri të ndaluar (I mituri i moshës prej 10 deri në 13 vjeç)</p>
---	---

Informacionet e mësipërme duhet t'ju jipen në një gjuhë të cilën ju e kuptoni.

Ju mund të ruani këtë dokument gjatë gjithë kohëzgjatjes së mbajtjes nën arrest

Jeni informuar se jeni vendosur nën arrest sepse ekzistojnë kundër jush elemente të rënda dhe vërtetuese për të supozuar se ju keni kryer ose jeni përpjekur të kryeni një vepër penale të ndëshkueshme me një dënim me burg të paktën prej 5 vjet.

Ju keni të drejtë të njihni kualifikimin, datën dhe vendin e supozuar të kryerjes së veprës penale për të cilën ju jeni akuzuar dhe arsyet justifikuese të ndalimit tuaj.

Ju do të dëgjoheni mbi këto fakte gjatë mbajtjes nën arrest që mund të zgjasë dymbëdhjetë orë.

Në fund të kësaj periudhe, prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari i të miturve) do të mund të vendosë zgjatjen e ndalimit për një periudhë tjetër prej dymbëdhjetë orësh. Përveç se në rast pamundësie, ju do të paraqiteni atëherë para këtij magjistrati, nëse është e nevojshme me anë të video-konferencës.

Në përfundim të mbajtjes nën arrest, me urdhër të prokurorit (ose gjyqtarit të hetimeve paraprake ose të gjyqtarit të të miturve), ju ose do të paraqiteni përpara këtij magjistrati, ose do të liroheni.

GJITHASHTU JU INFORMOJMË SE KENI TË DREJTËN TË :

Lajmëroni disa persona të caktuar

Një oficer ose agjent i policisë gjyqësore do të lajmërojë prindërit tuaj ose kujdestarin tuaj, ose personin ose shërbimin që kujdeset për ju lidhur me masën e arrestit kundrejt jush.

Nëse keni kombësi të huaj, ju gjithashtu mund të njoftoni autoritetet konsullore të vendit tuaj.

Prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari i të miturve) mund të kundërshtojnë këto kërkesa për arsye hetimore. Me përjashtim të rrethanave të pakapërcyeshme, këto kërkesa do të ekzekutohen pas një maksimumi prej 3 orësh duke filluar nga momenti kur keni formuluar kërkesën tuaj

Kontrollim nga një mjek

Prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari i të miturve) do të caktojë kryesisht një mjek që t'ju vizitojë. Në rast të zgjatjes së ndalimit, prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari i të miturve) do të caktojë kryesisht një mjek që t'ju vizitojë përsëri.

Dhënie e deklaratave, përgjigja ndaj pyetjeve ose ruajtja e heshtjes

Pasi keni deklaruar identitetin tuaj, ju keni të drejtën, gjatë marrjes suaj në pyetje :

- të jipni deklarata,
- t'i përgjigjeni pyetjeve që ju janë drejtuar,
- ose të heshtni.

Asistenca nga një avokat

- Zgjedhja e avokatit

Që në fillim të ndalimit dhe në rast të zgjatjes së ndalimit, që në fillim të kësaj zgjatjeje, ju mund të kërkonti të asistoheni nga një avokat i zgjedhur prej jush. Nëse ju nuk jeni në gjendje të caktoni një avokat ose nëse avokati i zgjedhur nuk mund të kontaktohet, ju mund të kërkonti që një avokat t'ju caktohet automatikisht.

Avokatin tuaj mund ta caktojë gjithashtu prindërit tuaj ose kujdestari juaj, ose personi apo shërbimi që kujdeset për ju.

Në mungesë të sa më sipër, oficeri i policisë gjyqësore ose prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari i të miturve) do të kërkojnë caktimin e një avokati kryesisht për ju.

- Asistenca dhe periudha e ndërhyrjes së avokatit

Avokati:

- do të takohet me ju gjatë 30 minutave në kushte që garantojnë konfidencialitetin e takimit;
- do t'ju ndihmojë në marrjet në pyetje dhe ballafaqimet tuaja

Marrja juaje parë në pyetje, me përjashtim të rastit kur përfshin vetëm elemente identiteti, nuk mund të fillojë në mungesë të avokatit tuaj përpara përfundimit të një periudhe prej dy orësh pas njoftimit që i është bërë atij lidhur me kërkesën tuaj. Sidoqoftë, marrja juaje parë në pyetje mund të fillojë menjëherë, megjithë mungesën e avokatit tuaj, me autorizim të prokurorit (ose të gjyqtarit të hetimeve paraprake ose gjyqtarit të të miturve), nëse kërkohet për nevoja të hetimit.

Nëse avokati juaj paraqitet gjatë marrjes në pyetje ose ballafaqimit, ky akt do të ndërpritet për t'ju dhënë mundësi të takoheni me të.

Prokurori (ose gjyqtari i hetimeve paraprake ose gjyqtari i të miturve) dhe gjyqtari i lirive dhe i ndalimit munden megjithatë, për arsye madhore dhe në kuadër përjashtimor, të vendosin për një shtyrje të asistencës nga avokati juaj gjatë marrjes në pyetje, për një periudhe prej 12 orësh, me një mundësi ripërsëritje

Asistenca e përkthyesit

Nëse ju nuk e flisni apo nuk e kuptoni frëngjishten, keni të drejtën të kërkonti asistencë falas nga një përkthyes gjatë marrjes suaj në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj.

E drejta për të kërkuar përfundimin e ndalimit

Ju mund t'i kërkonti prokurorit ose gjyqtarit të hetimeve paraprake apo gjyqtarit të të miturve, kur ai të shprehet për një zgjatje të mundshme të ndalimit, që kjo masë mos të zgjatet.

Qasja në disa pjesë të dosjes suaj

Me kërkesën tuaj ose të avokatit tuaj, ju mund të kërkonti të shikoni, jo më vonë se para një zgjatjeje të mundshme të ndalimit :

- procesverbalin e lajmërimit të ndalimit tuaj;
- certifikatën/-at mjekësore të nxjerra nga mjeku që ju ka vizituar.
- procesverbalin/-et e marrjes tuaj në pyetje

Informacion mbi rrjedhen e e procedurave

Në përfundim të ndalimit, nëse nuk është marrë asnjë vendim nga prokurori mbi vazhdimin e procedurës, në fund të një periudhe prej 6 muajsh, ju mund të pyesni prokurorin lidhur me bazën ligjore në të cilën është marrë masa mbi vazhdimin që ai ka ndërmend t'i japë kësaj çështjeje.